



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı



01 Nr. 140/26 Dt. 26.03.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 1 paragrafi 2, nenit 3 paragrafi 2 dhe nenit 14 paragrafi 1, lidhur me nenin 18 paragrafi 1.9 i Rregullores Komunale nr. 001-011-201, datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës 01-030-31751, datë 17.03.2026, të Dionis Berisha, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e mjeteve

1. Miratohet kërkesa 01-030-31751, datë 17.03.2026, e Dionis Berisha nga Prizreni, student në Fakultetin e Arteve "Haxhi Zeka" në Pejë, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve rreth pjesëmarrjes në Garat Ndërkombëtare të Kitarës, të cilat do të mbahet nga data 02 prill 2026 deri me 04 prill 2026 në Kystendil të Republikës së Bullgarisë, kështu që, për këtë qëllim dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve të udhëtimit dhe regjistrimit, lejohen mjetet financiare në shumën prej 300 € (treqind euro).
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës.
3. Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Të lartcekurit,
 - Arkivës së Kryetarit.

